



RAPORTI VJETOR

Për Organizatat Jo Qeveritare të regjistruara në Kosovë, mbajtëse të Statusit për Përfitim Publik

Për periudhën financiare deri më 31/12/2016

Në përputhje me Ligjin nr. 04/L-57 të gjitha OJQ-të e regjistruara në Departamentin për OJQ, të cilave në vazhdim i'u është dhënë Statusi i Përfitimit Publik duhet të përgatisin një raport vjetor. Ju lutemi, keni kujdes që detajet që i ofroni më poshtë të jenë të sakta dhe complete.

Pjesa I - Menaxhmenti dhe Administrata

(A) Ky raport është plotësuar nga:

Emri i Organizatës dhe shkurtesa The American Chamber of Commerce in Kosovo, AmCham	Numri i telefonit
	Numri i faksit
Adresa Perandori Justinian Nr.132, 10000 Prishtinë, Kosovë, Prishtinë	Adresa elektronike info@amchamksv.org

(B) Kjo organizatë është: Fondacion Shoqatë Institut

(B1) Organizatë vendore

(B2) Organizatë ndërkombëtare

(B3) Organizatë e vendit të huaj

(C) Emri dhe titulli i përfaqësuesit të autorizuar të organizatës?

Emri i përfaqësuesit të autorizuar Arian Zeka	Titulli Drejtor Ekzekutiv
---	-------------------------------------

(C1) Emri i organit më të lartë udhëheqës: **Kuvendi**

Pjesa II - Raporti i aktiviteteve dhe të arriturave

(A) Cili është misioni i organizatës (sipas Statutit)?

///

(B) (1) Cilat janë programet kryesore të organizatës?

**SHOQËRI PER SHOQRIN
ZHVILLIM ORGANIZATIV
RINDËRTIM**

(B) (2) Cilat janë veprimet të cilat i ndërmerr organizata për t'i zbatuar programet e (B)(1), cekura më lartë?

Avokimi në OEAK funksionon përmes komiteteve të saj. Komitetet dhe grupet punuese të OEAK funksionojnë si degë formale të Odës, duke pasur qëllim adresimin e çështjeve kritike që ndikojnë në funksionimin e ndonjë sektori apo industrie të caktuar. Takimet e komiteteve rezultojnë në nxerrjen e rekomandimeve për Bordin e Drejtorëve, dhe këto rekomandime pastaj mund t'u komunikohen ministrive apo agjencive përkatëse në Kosovë.

OEAK i ndihmon anëtarët e saj për të rritur dukshmërinë e tyre dhe për t'u lidhur me klientë, furnizues apo partnerë afaristë potencial. Si anëtarë i OEAK, kompanitë ftohen në organizime që u japin rastin të takohen me liderë dhe zyrtarë qeveritarë, të biznesit dhe të komunitetit- lokal dhe ndërkombëtarë- që janë të përfshirë në formësimin e së ardhmes ekonomike në Kosovë. Kompanitë mund të lidhen me klientë, furnizues apo partnerë potencial është përmes grupeve punuese të OEAK-së. Stafit i Odës është gjithashtu i autorizuar për të asistuar bizneset duke ndihmuar në krijimin e kontakteve me kompani amerikane, organizata komerciale dhe agjenci që operojnë në Shtetet e Bashkuara apo në ndonjë shtet tjetër në rajon.

Duke pasur parasysh që një nga qëllimet e Odës është nxitja dhe lehtësimi i partneriteteve ndërmjet bizneseve, Oda rregullisht organizon takime Biznes me Biznes në nivel lokal si dhe jashtë vendit. Në të kaluarën, OEAK ka organizuar me sukses disa takime Biznes me Biznes në Shtetet e Bashkuara, Greqi, Slloveni, Holandë, Bosnje, Gjermani, Austri, Zvicër etj.

Njëra ndër objektivat parësore të Odës Amerikane në Kosovë është që t'u ofrojë investitorëve amerikanë dhe atyre të jashtëm, dhe bizneseve kosovare në përgjithësi, një platformë ku ata mund të paraqesin brengat dhe idetë për politika të reja qeveritare ose për përmirësimin e atyre ekzistuese. Këto brenga dhe ide më tej pasqyrohen në disa dokumente të nxjerra nga Oda Amerikane të njohura si Dokumente Pozicionuese. Përmes hulumtimeve, takimeve të komisioneve, forumeve të biznesit dhe konferencave, Oda Amerikane zhvillon dokumentet pozicionuese të cilat përdoren si mjet gjatë përpjekjeve për avokim dhe lobim. Disa prej dokumenteve të fundit pozicionuese të Odës Amerikane përfshijnë Dokumentin Pozicionues mbi Luftimin e Korrupsionit, Dokumentin Pozicionues për Pakon Fiskale, Dokumentin Pozicionues mbi Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive, Dokumentin Pozicionues mbi Kërcënimet ndaj Investitorëve, Dokumentin Pozicionues për Rifunksionalizimin e Bordit të Pavarur për Rishqyrtime, Dokumentin Pozicionues mbi Eliminimin e Mëtejshëm të Pengesave në Aktivitetet e Biznesit nga ana e Qeverisë dhe Dokumentin Pozicionues Pezullimin e Ligjit për Sigurimet Shëndetësore.

Falë mbështetjes financiare të USAID përmes projektit USAID Forward Initiative, Oda Amerikane ofron shërbime të arbitrazhit dhe ndërmjetësimit për konteste të natyrës ekonomike mes palëve të biznesit. Arbitrazhi dhe ndërmjetësimi janë forma alternative të zgjidhjeve të kontesteve krahas procedurave tradicionale gjyqësore.

Misionet për rritjen e tregtisë- janë zakonisht të organizuara jashtë vendit. Oda dërgon delegacione të bizneseve dhe të përfaqësuesve qeveritarë në mënyrë që të promovohen mundësitë e investimit në Kosovë dhe partneritetet e biznesit. Këto misione gjithashtu shërbejnë për të mësuar nga praktikat më të mira të biznesit në vendin mikpritës.

Oda Amerikane organizon punëtori ose trajnime përmes të cilave synohet edukimi ose rritja e vetëdijes së anëtarësisë së saj dhe palëve të tjera të interesit për çështje ose tema të caktuara. Trajnimet organizohen edhe në bashkëpunim me partnerë të Odës Amerikane, siç është rasti me Shkollën e Menaxhmentit të Bledit (Slloveni). Poashtu, për dy vite me radhë, Oda Amerikane ka organizuar edhe Shkollën për Thellimin e Njohurive mbi Bashkimin Evropian (ose Shkollën e Integritimeve Evropiane), ku përfitues përveq bizneseve janë edhe përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, respektivisht ministrive të caktuara dhe agjencive të pavarura.

Kryerja e hulumtimeve në fusha të caktuara, qëllimi i të cilave është nxjerrja e të gjeturave, të dhënave dhe statistikave, të cilat do të mundësojnë pasqyrimin më real ose numerik të çështjeve për të cilat avokon Oda Ekonomike Amerikane.

(C) Cilat janë të arriturat kryesore të programeve për periudhën nga 01/01/2016 deri më 31/12/2016?

Pezullimi i ligjit për sigurimet shëndetësore, deri në plotësim të të gjitha kriterëve ligjore të parapara para fillimit të mbledhjes së premieëve shëndetësore

Aprovimi nga ana e Kuvendit të Kosovës të Ligjit për Kamatvonesa, iniciativë kjo e Odës Ekonomike Amerikane e nisur në vitin 2010

Dhënia e komenteve për Ligjin për Fondin e Garantimit të Kredive

Ofrimi dhe marrja në konsideratë e komenteve dhe propozimeve për masat fiskale të përfshira në të ashtuquajturën Pako Fiskale 2.0.

Vendimi për krijimin e një njësie të re funksionale të Odës Amerikane e cila do të merret me kryerjen e hulumtimeve dhe prodhimin e të dhënave kualitative dhe kuantitative. Kjo njësi do të njihet si Instituti i Hulumtimeve Ekonomike Theodor Roosevelt dhe do të funksionojë si departament funksional i Odës Ekonomike Amerikane.

Oda Amerikane poashtu ka organizuar aktivitete me zyrtarët më të lartë të institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare, përfshirë edhe përfaqësive diplomacive në vend. Tryezat e tilla kanë përfshirë pjesëmarrës ose panelistë si: Ambasadori Amerikane Greg Delawie, Kryetari i Kuvendit Kadri Veseli, Kryeministri Isa Mustafa, Ministri i Financave Avdullah Hoti, Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë Hykmete Bajrami, Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale Arban Abrashi, Ministri i Zhvillimit Ekonomik Blerand Stavileci, Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Memli Krasniqi, Ministrja e Drejtësisë Dhurata Hoxha, Drejtori i Doganës Lulzim Rafuna, Djejtori i Administratës Tatimore të Kosovës Sakip Imeri, udhëheqësit e programeve të financuara nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar, etj. Përveq adresimit të çështjeve specifike që lidhen me fushëveprimin e institucioneve të sipërcekura, qëllimi i organizimit të këtyre aktiviteteve është edhe zhvillimi dhe fuqizimi i dialogut ndërmjet sektorit privat dhe sektorit publik.

E arritur tjetër, është edhe pjesëmarrja aktive e Odës Amerikane në mekanizmat formal ndërinstitucional, siç është rasti me Këshillin Kombëtar për Zhvillimin Ekonomik, ku është prezantuar nga Oda Amerikane edhe kërkesa për heqjen e tarifave të ndryshme sezonale të energjisë elektrike dhe heqja e të ashtuquajturit maksigraf, ankesë kjo e kahmotshme e bizneseve, sidomos atyre prodhuese. Këto kërkesa i janë adresuar Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Kërkesë tjetër e adresuar me sukses nga ana e Odës Amerikane është ajo e nxjerrjes së një akti ligjor ose nënligjor për rregullimin e lëndëve të evaporueshme ose atyre që pësojnë humbje teknike për shkak të natyrës specifike, si produktet e naftës, pemët e perimet, etj. Kjo kërkesë tashmë është përfshirë edhe në Pakon Fiskale 2.0, e cila pret të aprovohet gjatë vitit 2017.

E arritur tjetër është edhe nxjerrja e dy vëllimeve të Buletinëve të Zgjidhjes Alternative të Kontesteve, publikim ky unik në Republikën e Kosovës.

(D)(1) A angazhohet organizata në aktivitete tjera përveç atyre që janë aktivitete për Përfitim Publik, sikur që është definuar në Ligjin Nr. 04/L-57

Po

Jo

Nëse jeni përgjigjet me Po, atëherë përshkruani këto aktivitete shkurtimisht:

(D)(2) A ka marrë pjesë organizata në ndonjë transaksion financiar me zyrtarë, drejtorë, të punësuarit ose me anëtarët e familjeve të tyre?

Po

Jo

*Nëse jeni përgjigjet me **Po**, ju lutemi që të identifikoni transaksionet e tilla në vendin e caktuar më poshtë. Duhet të shënoni emrin dhe vendin e punës së personit i cili ka qenë i angazhuar në transaksionet e tilla; çfarë fonde apo përfitime ka pasur organizata në atë transaksion; çfarë fonde dhe përfitime ka marrë personi në këtë transaksion; sa është pagesa e rrogave dhe e fitimeve për zyrtarët, drejtorët, punonjësit apo anëtarët e familjes së tyre, apo organizatave anëtare të OJQ-së. Ndonjë informacion tjetër që shpjegon natyrën e transaksionit.*

*Nëse jeni përgjigjetur me **Jo**, ju duhet të plotësoni certifikatën në faqen 8*

(F) Nëse organizata e juaj është rrjet i organizatave, a është e angazhuar organizata në ndonjë transaksion financiar me organizatat e anëtarësuarat?

Po

Jo

Nëse jeni përgjigjetur me Po, luteni që të identifikoni transaksionin e tillë në vendin e caktuar në vijim. Organizata e anëtarësuar është ajo me të cilën OJQ-ja, drejtorët, zyrtarët, stafi i saj apo të afërmit e tyre kanë një interes të pronësisë apo të menaxhimit. Duhet të cekni emrin dhe adresën e organizatave të anëtarësuarat; natyrën e marrëdhënieve në mes të organizatave; Çfarë fonde dhe përfitime kanë marrë OJQ-të në transaksione, çfarë fonde dhe beneficione kanë marrë organizatat e anëtarësuarat në transaksion, dhe informata tjera që shpjegojnë natyrën e transaksionit

*Nëse jeni përgjigjetur me **Jo**, ju duhet të plotësoni certifikatën në faqen 8*

Pjesa III

Emri i OJQ-së: The American Chamber of Commerce in Kosovo

Bilanci i gjendjes 31/12/2016

AKTIVA		PASIVA	
	Shënimi shumën këtu		Shënimi shumën këtu
Para të gatshme	92,605.00	Llogaritë e pagueshme	32,600.00
Llogaritë e arkëtueshme	247,357.00	Detyrimet ndaj granteve	0.00
Llogaritë tjera të arkëtueshme	0.00	Të hyrat e pafituara	285,171.00
Stoqet	0.00	Hipoteka dhe detyrimet ndaj letrave me vlerë	0.00
Parapagimet e shpenzimeve	5,348.00	Detyrimet tjera	35,213.00
Investimet:	0.00	Gjithsej detyrimet:	352,984.00
Letrat me vlerë	0.00		
Toka, ndërtesat, pajisjet në përgatitje	0.00	Fondi i OJQ-së:	1,093.00
Kreditë e dhëna (konsumatorëve)	0.00	Fondi i bartur më 01/01/2016	1,093.00
Toka, ndërtesat, dhe pajisjet	8,766.00	Të tjera	0.00
Pasuritë tjera	0.00	Të hyrat neto (Shih P/A)	0.00
		Gjithsej fondi:	1,093.00
Gjithsej pasuria:	354,076.00	Gjithsej detyrimet dhe kapitali	354,076.00

Pasqyra e të ardhurave

TË HYRAT		SHPENZIMET	
	Shënoni shumën këtu		Shënoni shumën këtu
Të hyrat nga kontributet, dhuratat apo grantet	241,353.00	Shpenzimet programore	177,133.00
Të hyrat nga aktivitetet ekonomike	168,264.00	Shpenzimet e menaxhimit dhe administratës	233,295.00
Të hyrat nga borxhet e këqija	0.00	Shpenzimet tjera	3,902.00
Të hyrat nga interesi dhe dividenda	0.00	Gjithsej shpenzimet:	414,330.00
Të hyrat nga qiraja	0.00	Të hyrat neto nga operacionet:	0.00
Të hyrat tjera:	4,713.00		
Fitimi nga shitja e pasurisë	0.00		
(humbja nga shitja e pasurisë)	0.00	Shpenzimet e tatimit	0.00
Të hyrat tjera të veçanta	0.00		
Të hyrat nga shitja e mallit	0.00		
(Kosto e mallit të shitur)	0.00		
Të hyrat tjera	0.00		
Gjithsej të hyrat:	414,330.00	Të hyrat neto:	0.00

Pjesa IV Certifikatat

Ju lutemi, kontrolloni çdo paragraf që vlen për organizatën tuaj:

- Me anë të kësaj vërtetohet se nuk është paraqitur asnjë transaksion për periudhën deri më **31/12/2016** në mes të organizatës dhe zyrtarëve, drejtorëve, të punësuarve të saj, anëtarëve të familjeve të tyre, apo organizatave anëtare të OJQsë.
- Me anë të kësaj vërtetohet se nuk ka pasur asnjë transaksion gjatë periudhës deri më **31/12/2016** në mes të organizatës dhe organizatave të anëtarësuarra.
- Me anë të kësaj vërtetohet se organizata nuk ka ndarë asnjë fond ose nuk ka ndërmarrë asnjë fushatë për të ndihmuar partitë politike apo kandidatët e punësuar apo të zgjedhur për zyrat publike, apo për regjistrimin ose aprovimin e kandidatëve të punësuar ose të zgjedhur për zyrat publike për periudhën deri më **31/12/2016**.
- Me anë të kësaj vërtetohet se sektori financiar i këtij raporti vjetor ka qenë kontrolluar nga një auditor i pavarur, raporti i të cilit i është bashkëngjitur këtij raporti vjetor.
- Me anë të kësaj vërtetohet se pjesët e këtij raporti vjetor si në vijim organizata i konsideron si konfidenciale dhe informatat në këto pjesë janë të bashkëngjitura në formularin për kërkesën për trajtimin konfidencial të tyre, sipas nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit Nr. 04/L-57.
(Shënoni qartë pjesët e raportit që kërkon të trajtohen në mënyrë konfidenciale)

ASNJE

Të dhënat në këtë raport vjetor janë të vërteta dhe të sakta.

Arian Zeka

Shënoni emrin e përfaqësuesit të autorizuar me shkronja të shtypit

Nënshkrimi i personit të autorizuar

14/07/2017

Datë

Formulari A

Ky formular duhet të kompletohet vetëm nga organizatat të angazhuara në aktivitetet për përfitim publik në fushat e arsimit, shëndetësisë apo zhvillimit ekonomik.

Shëno këtu nëse organizata është e angazhuar në aktivitetet për përfitim publik në fushën e arsimit dhe shëndetësisë.

(Nëse keni plotësuar këtë katror, ju lutemi kompletoni pyetjet 1 dhe 2 dhe certifikatën në pyetjen 3.)

(1) Emëroni grupet ose individët në kushte të pavolitshme të cilët i shërben organizata?

(2) Shënoni mallrat, shërbimet dhe përfitimet tjera që i ofrohen grupeve apo individëve të identifikuar në përgjigjen e pyetjes 1 të lartëcekur.

(3) Plotësojeni njërin prej katrorëve:

Me anët të kësaj vërtetoj se mallrat, shërbimet apo përfitimet tjera të përshkruara në përgjigjen e pyetjes nr. 2 ofrohen pa pagesë për organizatën.

Me anët të kësaj vërtetoj se mallrat, shërbimet apo përfitimet tjera të përshkruara në përgjigjen e pyetjes nr. 2 ofrohen me çmim më të ulët se çmimi i tregut

Nëse e kemi plotësuar këtë katror, ju lutemi sqaroni në hapësirën në vijim cili ka qenë çmimi që kemi paguar për përfitime dhe si jeni përcaktuar se çmimi ka qenë më i lirë se çmimi i tregut.

Plotësoni këtë katrorë nëse organizata angazhohet në aktivitetet për përfitim publik në fushën e zhvillimit ekonomik.

(Nëse keni plotësuar këtë katror, ju lutemi përgjigjuni në pyetjen nr. 4 në vijim)

(4) Shënoni grupet ose individët në kushte të pavolitshme të cilët i shërben organizata?

Ndermarrjet e sektorit privat

Gjendja e dhënë në formularin A është e vërtetë dhe e saktë.

Arian Zeka

Shënoni emrin e përfaqësuesit të autorizuar me shkronja të shtypit

Nënshkrimi i personit të autorizuar

14/07/2017

Datë

Formulari B

Ky formular duhet të kompletohet nëse organizata është shpërbërë, shuar apo çregjistruar, gjatë periudhës deri më 31/12/2016.

Plotësoni këtë katrorë nëse organizata është shpërbërë, shuar apo çregjistruar gjatë periudhës prej regjistrimit deri në

Plotësoni këtë katrorë nëse ky raport është raport përfundimtar vjetor të cilin organizata duhet ta fus në dosje.

(1) Data e shpërbërjes, shuarjes, çregjistrimit _____

(2) Emri dhe informatat kontaktuese të likuidatorit janë:

Emri	Numri i telefonit
	Numri i faksit
Adresa	Adresa elektronike

(3) Çfarë dispozitash janë përgatitur për likuidimin e punëve të organizatës?

(4) Cila është shuma e aktivës neto që ka organizata pas likuidimit të punëve të saj? _____

- (5) Si i ka organizuar organizata fondet e saja dhe-apo aktivën e saj të identifikuar në përgjigjen e dhënë në pyetjen 4 më lartë?

Nëse fondet i janë transferuar një OJQ-je tjetër, ju lutemi shënoni emrin e asaj OJQ-je, numrin e saj të regjistrimit, emrin dhe informatat kontaktuese të përfaqësuesit të autorizuar dhe datën e transferit.

- (6) Organizimi i aktivës së organizatës është bërë (Plotëso njërin prej katrorëve):

- në pajtim me dispozitat e statuteve të organizatës;
- me votën e organit më të lartë udhëheqës të organizatës; apo
- me vendim të Organit Kompetent

- (7) Ju lutemi, të bashkangjitni një kopje të raportit përfundimtarë të likuidatorit.

(Të organit i cili ka marrë vendim mbi shuarjen)

Gjendja e dhënë në formularin B është e vërtetë dhe e saktë.

Shënoni emrin e përfaqësuesit të autorizuar me shkronja të shtypit

Nënshkrimi i personit të autorizuar

Datë